



VENDIM

Nr. 69 , datë 27.12.2017

PËR

“MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË RROGOZHINË PËR VITIN 2018 ”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me dt.27. 12. 2017, analizoi ,diskutoi dhe mori në shqyrtim Relacionin e ardhur nga Bashkia, me shkresën Nr.4305. Prot, datë 27.12.2017 “Për diskutimin dhe miratimin e projekt buxhetit të Bashkisë të vitit 2018”.

Në mbështetje të gërmës “dh” të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore“ . Mbështetur në Ligjin nr.9936,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 38, të nenit 19 te ligjit nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”,të Aktit normativ nr.2 dt.16.12.2016”Disa ndryshime në ligjin nr.147/2015 “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2016”, të ligjit nr.130/2016 “Për Buxhetin e vitit 2017”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI :

MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË RROGOZHINË PËR VITIN 2018 .

Detajuar si më poshtë vijon :

Meqenëse ne kemi bërë një paraqitje të të dhënave kryesore të realizimit si 11-mujor mendojmë që për realizimin e shpenzimeve dhe të Ardhurave për vitin 2017 të mos merremi gjerësisht pasi shumica e të dhënave janë ezauruar.

Bashkia Rrogozhinë është në vitin e tretë të plotë në zbatimin e Ligjit nr. 115/2014”Për ndarjen Administrativo – Teritoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë,viti 2017 është një vit Buxhetor më i stabilizuar dhe me tregues ekonomikë më të përshtatëshëm”



Për vitin 2018 ka pasur një përgatitje më të hershme të Buxhetit, ku në disa takime janë diskutuar me punonjësit e njësisve Vendore dhe duke qenë se një numur i konsiderueshëm relacionesh shpjeguese janë dhënë nga Sektori i Sherbimeve, për shumë tregues ekonomikë mbi të cilat është mbështetur edhe përgatitja e Buxhetit, mendojmë që për Buxhetin e vitit 2018 të japim disa shpjegime për mënyrën se ai është përgatitur.

Buxheti i vitit 2018 përsëri është i përbërë në dy ndarje kryesore që janë:

- Buxheti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore dhe,
- Buxheti I Pakushtëzuar për Funkcionet shtesë për vitin 2018.

Do ju tërheqim vëmendjen për tju shpjeguar se përse këtë vit buxheti është pasqyruar në mijra lekë. Përgjigja është e thjeshtë:

- Është hera e parë që Buxheti miratohet para mbylljes së vitit Ushtrimor.
- Akoma nuk janë përcaktuar saktë nga ana e Min.Fin.sasia pas masës së plotë të dhënës deri tani.
- Akoma nuk janë saktësuar nga ana e Degës së thesarit të Ardhurat dhe grantet e përealizuara që trashëgohen për vitin 2018.

Për këtë do të na lindë rishikimi i Buxhetit e cila nuk do të jetë një proces i vështirë pasi pothuajse tërë struktura e buxhetit është tashmë e ngritur.

Buxheti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore përbëhet nga 18 nëndarje përsa I përket shpenzimeve që janë si më poshtë:

- 00/1110/01/600 (grupi, titulli, kapitulli, artikulli) "Paga për personelin e aparatit"
- 00/8140/01/600 "Paga për sportin"
- 00/8230/01/600 "Paga për Kulturën"
- 00/1110/01/601 "Sig. Shoq dhe Shëndetës. Për personelin e Aparatit"
- 00/8140/01/601 "Sig. Shoq. Dhe Shënd. Per sportin"
- 00/8230/01/601 "Sig. Shoq. Dhe Shënd. Per Sektorin e Kulturës".
- 00/1110/01/604 "Trasferta të Brëndëshme" që përfaqëson 1 % e Qarkut (1% e të Ardhurave të Planifikuara)
- 00/1110/01/606 "Ndihma Ekonomike Nga Nësia Vendore për familjet në nevojë (3% e Buxhetit të përgjithshëm)
- 00/1110/01/609 "Fond I emrgjencave" (rreth 2% e Buxhetit të Përgjithshëm)
- 00/1110/01/602 "Shpenzime Operative për aparatit" ku këtu futen edhe pagat për Këshilltarët dhe Administratorët (kryepleqtë).
- 00/8140/01/602 "Shpenzime Operative per Sportin"
- 00/8230/01/602 "Shpenzime Operative për Kulturën"
- 00/9120/01/602 "Shpenzime Operative për Arsimin" që ka qenë funksion edhe I mëparshëm pamvarësisht Funksioneve të reja të Arsimit.
- 00/6260/01/602 "Shpenzime Operative në Funksion të Pastrimit"
- 00/6260/01/602 "Shpenzime Operative në Funksion të Gjelbërimit"
- "Shpenzime Operative në Funksion të Mirëmbajtjes së Varrezave"
- "Shpenzime Operative në Funksion të Dekorit të Qytetit"
- 00/1110/01/230 "Shpenzime Kapitale për Studime e Projekte" që është shumë I rëndësishëm në fazën e planifikimit të fondeve për Investime. edhe këtë vit do të kemi shumë projekte që do ti hapin rrugën në një të ardhme jo shumë të largët aktivizimit të tyre.
- 00/1110/01/231 "Shpenzime kapitale për Rritjen e Aktiveve"



- 00/4530/01/231 “Shpenzime Kapitale nga Fondi I Zhvillimit të Rajoneve” për pjesën e Grantit të trashëguar nga viti I kaluar.

Buxheti I Pakushtëzuar I Funksioneve të reja përbëhet nga zërat e mëposhtëm:

- ❖ 00/9120/01/600 “Pagat e Arsimit Parashkollor Bazë”
- ❖ 00/9120/01/601 “Sig.Shoq. dhe Shëndets. Të Arsimit Parashkollor Bazë”
- ❖ 00/9230/01/600 “Pagat e Arsimit Parauniversitar”
- ❖ 00/9230/01/601 “Sigurimet Shoq. Dhe Shëndetës. Të Arsimit Parauniversitar”
- ❖ 00/4240/01/600 “Pagat e Sekt. Të Ujitjes dhe Kullimit”
- ❖ 00/4240/01/601 “Sigurimet Shoq. Dhe Shëndets. Te Sekt. Të Ujitjes dhe Kullimit”
- ❖ 00/4240/01/602 “Shpenzime Operative të Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, që janë të përcaktuara.
- ❖ 00/4260/01/600 “Pagat e Sektorit të Administrimit të Pyjeve”
- ❖ 00/4260/01/601 “ Sigurime Shoq. Dhe Shëndets. Të Administrimit të Pyjeve”
- ❖ 00/4260/01/602 “Shpenzime Operative të Sekt. Të Administrimit të Pyjeve.
- ❖ 00/10910/01/600”Pagat e Sekt. Të Mbrojtjes nga Zjarri”
- ❖ 00/10910/01/601”Sig.Shoq. dhe shënd. Të Sekt. Të Mbrojtjes nga Zjarri”
- ❖ 00/10910/01/602”Shp.Operative të Sekt. Të Mbrojtjes nga Zjarri”

Buxheti në tërësinë e vet si kryesore ka Balancimin e tij,pra të Ardhurat të baraspeshohen me shpenzimet.

TE HYRAT(Të Ardhurat)

Për të Ardhurat e vitit 2018 ,kjo vetëm për Buxhetin e Pakushtëzuar të Qeverisjes Vendore, kemi 6(Gjashtë) burime.

1. Të ardhurat nga Granti I trashëguar nga viti I kaluar në shumën 997.000 lekë që përfaqëson, vlerën e trashëguar nga Fondi I Zhvillimit Të Rajoneve për vitin 2018.
2. Të ardhura të trashëguara nga granti I vitit 2017 I Min.Bujqësisë në vlerën 11.736.000 lekë për pastrimin e kanaleve.
3. Të ardhura të trashëguara nga granti I vitit 2017 I Min.Financave në vlerën 21.514.000 lekë për shpenzime të përcaktuara.
4. Vlera e Trashëguar nga të Ardhurat e Vitit 2017 në shumën 8.887.000 lekë që përfaqëson shumat e pa alokuara të të Ardhurave deri ne Nëntor 2017 .
5. Granti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore në shumën 134.879.000 lekë, I cili akoma nuk ka një specifikim të saktë në rastin e kufizimeve,por ne kemi respektuar vetëm kufizimin në fondin e pagave, 40% të Grantit është përdorur për Pagat.
6. Të ardhurat të Planifikuara për vitin 2018 në shumën 218.765.000 lekë,kjo pasqyrohet në planin e të Ardhurave bashkëngjitur Buxhetit.

Të hyrat gjithsej janë 395.778.000 lekë pa përfshire ketu te hyrat nga Funksionet shtese..

Duke e parë Grantin do të shohim se kemi një rritje rreth 0 % në krahasim se vitin e kaluar kjo mbetet për tu parë por ka një rritje totali i Grantit për Bashkinë nga 130.224.000 lekë ne 134.879.000 lekë.
Për Grantet e Funksioneve shtesë kemi:



- Të Ardhurat nga granti për vitin 2018 për Arsimin Parashkollor në shumën 28.405.000 lekë
- Të Ardhurat nga granti për vitin 2018 për Arsimin Parauniversitar në shumën 2.313.000 lekë.
- Të Ardhurat nga granti për vitin 2018 për Ujitjen dhe kullimin 9.589.000 lekë.
- Të Ardhurat nga granti për Pyjet në masën 1.143.000 lekë.
- Të Ardhurat nga granti për Mbrojtjen nga Zjarri në masën 12.393.000 lekë

Gjithashtu kemi të Ardhura të trashëguara nga Funkcionet shtesë nga viti 2017 si më poshtë:

- Të ardhura të trashëguara nga 2017 për Arsimin Parashkollor në shumën 1532.000 lekë.
- Të ardhura të trashëguara nga 2017 për Arsimin Parauniversitar në shumën 261.000 lekë
- Të ardhura të trashëguara nga 2017 për Ujitjen dhe Kullimin 2.577.000 në shumën lekë
- Të ardhura të trashëguara nga 2017 Për Pyjet 222.000 lekë.
- Të Ardhura të trashëguara nga 2017 për Mbrojtjen nga Zjarri në masën 7.987.000 lekë

Objektivat kryesore të këtij Buxheti janë:

- ✚ Realizimi i shërbimeve me kryesore.
- ✚ Menaxhimi i pastrimit, gjelberimit, ndricimit Brenda standarteve që na lejojnë kushtet tona dhe mundësitë financiare.
- ✚ Ulja e varferisë duke përdorur rritjen e punësimit në shërbime me një vlerë minimale të pages.
- ✚ Realizimin e mirembajtjeve të Objekteve në limitet e lejueshme sipas mundësive financiare.
- ✚ Mbajtjen nën kontroll të Borxhit të prapambetur jo më shumë se 10 % të Buxhetit të përgjithshëm.
- ✚ Radha kronologjike e shlyerjes së detyrimeve.
- ✚ Mbajtjen e nën kontroll të nivelit mesatar të pagave.
- ✚ Rritjen Graduale të Investimeve me fondet tona duke mos dëmtuar nivelin e shërbimeve.

Duke vazhduar me analizën e buxhetit fillojmë me analizën e treguesve më kryesorë.

Tabelë për Të Ardhurat:

Më Poshtë kemi një tabelë ku analizohet realizimi I të Ardhurave deri në muajin Nentor 2017

Nr.	Emërtimi	Nr. Llogarise	Janar - Nentor Fakti 2017	Janar - Nentor Plani 2017	realiz. ne %	diferenca nga vjetori
1	Takse Biznesi Vogel	7002200	781.000	1.833.333	43.00	-1.218.644
2	Taks tokes bujqesore	7020100	18.161.555	20.933.423	87.00	-7.349.644
3	Taks Ndertese	7020200	10.329.763	11.581.373	89.00	-2.375.637
4	Takse kalim pronesie	7029200	931.699	1.200.000	75.00	+601.699
5	rregjistr. Vjetor I automj.	7033001	0	0	0	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



6	takse rregj.biznesi	7035001	0	10.000	0	-10.000
7	Taks tregu	7035002	13.410.900	23.004.001	58.00	-13.189.775
8	jeje ndertimi Kkrrt	7035003	3.995.225	10.300.000	39.00	-30.319.775
9	Takse Gjuetie	7035004	0	21.000	0	+21.000
10	Takse fjetje ne hotel	7035005	3.172.950	2.323.198	137.00	+448.334
11	Taks reklame	7035008	1.090.595	1.380.000	79.00	-190.595
12	Taks table	7035009	1.766.995	1.806.200	98.00	-16.995
13	Te tjera taksa tarifa	7035099	95.000	148.000	64.00	-65.000
14	takse akti dhe pulle	7081006	0	0	0	0
15	Takse trualli	7109200	404.475	0	0	+404.475
16	Qera	7109600	0	0	0	0
17	tarife akte administrativ	7110105	87.300	187.920	46.00	-47.049
18	Leje transporti	7110106	406.750	2.200.000	18.00	-1.093.250
19	Taks pastrimi	7110501	8.325.321	12.107.629	69.00	-4.068.287
20	kontrib.miremb.rruge	7110502	213.900	0	0	+213.900
21	Leje banimi	7110504	0	125.000	0	-125.000
22	Tarifa rregullatore	7110599				
23	te Ardh.nga kopshtet	7111001	30.700	0	0	+30.700
24	Taks parkimi	7111007	54.600	138.800	39.00	-74.110
25	Shitje prod.bujq.pyjore	7113001	95.250	85.400	111.00	+9.850
26	Gjoha	7115499	207.351	1.000.000	20.00	-792.649
27	gjoha nga sistemi tat.	7115001	0	0	0	0
28	Taks rregjistrim automjeti	7201101	3.363.051	3.700.000	91.00	-336.949
29	te tjera		2.000.000	24.777.007	8.00	-22.894.409
						0.00
	Gjithsej		74.043.375	124.331.284	59.60	-79.266.215

Për të Ardhurat,ajo që vlen të përmendet është fakti se:

- ❖ Të ardhurat nuk janë realizuar në masën e duhur për faktin e thjeshtë të mosrealizimit të lejeve të ndërtimit.
- ❖ Të mosrealizimit të Taksës së shfrytëzimit të Karburanteve.



❖ Të mosrealizimit të Rentës minerare.

Për të cilat mund të themi se së bashku shkojnë në rreth 70 milion lekë.(470 +140 +38)

Pasqyra nr 2 Investime.

Krahasimi i Investimeve per vitin 2016 dhe 2017.

000/leke

Nr.	EMERTIMI	NJESIA MATJES	Investime 2016		Investime 2017	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt
	INVESTIME GJITHSEJ	000/leke	217703	172151	320115	244169
A	Buxheti I Shtetit	000/leke	166898	160533	261436	218709
1	toka troje terrene,rruge	000/leke	157288	151256	243498	205109
2	Ndertesa	000/leke	9610	9277	8500	4545
3	Ndertime dhe Instalime te Pergj.	000/leke		0	9438	9055
B	Mjetet e Veta	000/leke	50805	11618	58679	25460
1	toka troje terrene	000/leke			38351	23202
2	Ndertesa	000/leke	6000	1895		
5	Orendi	000/leke				0
6	Ndertime dhe Instalime te Pergj.	000/leke	850	0	4250	3230
8	Mjete transoprti	000/leke			4500	0
9	Paisje zyre dhe informatike	000/leke	3600	2503		
10	Studime Projektme	000/leke	6200	4970	11578	9500
C.	Financime te Huaja	000/leke	0	0	0	0

Pasqyra e Investimeve.

Duke I krahasuar me një viti më parë Shpenzimet kapitale janë rritur me 10 herë .

Dhe po të shikojmë tabelën e mëposhtëme do të shohim realizimin e dy viteve të fundit.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2015	Viti 2016	Viti 217
A	Buxheti I Shtetit	13,991	160,533	218,709



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



1	toka troje terrene,rruge	12,107	151,256	205,109
2	Ndertesa	1,884	9,277	4,545
3	Ndertime dhe Instalime te Pergj.	0	0	9,055
B	Mjetet e Veta	1044	11,618	25,460
1	toka troje terrene	0	2,250	23,202
2	Ndertesa	0	0	0
3	Ndertime dhe Instalime te Pergj.	0	1,895	0
4	Instalime teknike makineri paisje	0	0	3,230
5	Paisje zyre dhe informatike	0	2,503	0
6	Studime Projektme	1044	4,970	9,500
	TOTALI i INVESTIMEVE	15.035	172.151	244.199

Duke I krahasuar shifrat e mësipërme nxjerrim konkluzionin se në total shpenzimet e planifikuara nga Buxheti I shtetit janë rritur 8 herë më shumë se viti 2016, dhe viti 2017 gati 2 herë më i madh se viti 2016që tregon se janë bërë përpjekje me Instutucionet përkatëse ,edhe në rrugë Individuale për rritjen e tyre dhe ajo që është kryesorja edhe investimet e kryera nga fondet tona pamvarësisht vështirësive janë realizuar gati 3 herë më shumë se viti 2015 dhe 20 herë më shumë se viti 2015 .

Pjesa që ndikon më shumë dhe që mund të quhet një Investim I kryer dhe që është paguar në masën gati 83 %është investimi prej 26 milion lekë për Studime dhe projektme të Planit të përgjithshëm rregullues që është miratuar nga ky Keshill Bashkiak.

Gjithashtu për këtë vit mund të themi se është hera e parë që është planifikuar të realizohen projekte,të cilat janë më të mëdha se mundësitë tona,por në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Urbanistikës është bërë ndryshe këtë vit:

- Kemi hartuar preventive me vlera më të mëdha se mundësitë e një viti dhe investimin e kemi ndarë në tre vite.
- Do të planifikojmë në buxhetin afatmesëm me përpikëmeri vlerën e mbetur të investimeve për dy vitet e ardhëshme.
- Në bashkëpunim me Degën e thesarit do të bashkëpunojmë që për Investimet e parashikuara në vitet 2019 dhe 2020,të sillen në vitin 2018 nëse realizohet plani i të ardhurave.

Kjo procedurë lindi si nevojë e domosdoshme e pamjaftueshmërisë së fondeve dhe nevojave të mëdha dhe imediate të infrastrukturës vendore,kjo do të mbështetet në një parashikim në zëra më të saktë të nevojave të tjera që mund të lindin dhe duke mos rritur Borxhin e brëndëshëm që deri më tani e kemi mbajtur në masën 12 % të Buxhetit total.

Shpenzimet.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2017 janë analizuar në Tabelën e mëposhtëme por sic e thamë edhe më sipër këtë vit ato kanë një masrealizim të qartë krahasuar me një vit më parë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



Shpjegimi është i tillë që nuk na ka ndodhur vite të tjera. që në dt.15 Nëntor 2017 në degën e thesarit vjen një urdhëresë e brendëshme për përcaktimin e limiteve mujore, të cilat kanë qenë gati sa 75 – 80 % të nevojave tona.

Tabela e mëposhtme tregon realizimin në % për dy vite kjo sa për informacion sepse për të dy vitet shpenzimet janë realizuar pothuajse në masën 100 % në shumicën e treguesve..

Nr	Emërtimi i artikullit të shpenzimeve	Viti 2016			Viti 2017		
		Plani	Fakti	Real %	Plani	Fakti	Real %
	Aparati						
1	Paga (600)	57886	57880	99.99	74690	64274	86.05
2	Sig.Shoq (601)	10435	10325	99.95	10920	10010	91.6
3	Shp.oper. (602)	25899	25841	99.78	34173	26804	78.4
4	Projekte (230)	4970	4970	100	19194	14500	75.5
5	Investim (231)	10955	6648	60.68	58678	21614	36.8
6	Investim nga F.Zhvillimit Riv.Urban	74985	74000	98.69	112441	112441	100.0
	Investim nga F.Zhvillimit Ujesj.	19963	19963	100.00	70497	70491	99.90
	Invest. Nga Min. e Bujqësisë	117319	57293	48.88	9055	9055	100.0
9	Investim Min Mirëqenies	9610	9277	100.0	8500	4545	53.5
8	Nd.ek.inv,(606+604)	123780	123780	100.00	126512	116433	92.03
10	Qark (604) + Keshilltaret	2452	2401	97.92	2342	2224	
11	Sherbimet Publike	29594	29538	98.81	42847	39609	92.4
12	KQZ	0	0	0	2342	2224	95.0
	Kultura	0	0	0			
1	Paga (600)	677	677	100.00	5640	1483	26.2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



2	Sig.Shoq (601)	113	113	100.00	1142	1046	91.6
3	Shp.oper. (602)	386	373	96.63	1854	1650	88.99
	Sporti	0	0	0			
1	Paga (600)	314	314	100.00	2628	8030	30.5
2	Sig.Shoq (601)	51	51	100.00	1401	400	28.6
3	Shp.oper. (602)	12147	12147	100.00	17895	15307	85.53
	Arsimi	21013	20996	99.84	27661	22048	79.7
	Gjendja Civile	0	0	0			
1	Sig.Shoq (600)	2764	2572	93.05	2800	2423	86.5
2	Shp.oper. (601)	463	412	88.58	483	424	87.8
3	606- Shpenzime lindje	800	800	100.0	1830	1830	100.0
	T O T A L I	517536	451329	87.21	757299	609813	80.5

Për planifikim e shpenzimeve për të gjithë sektorët është bashkëpunur me Sektorin e Shërbimeve dhe janë analizuar në hollësi të gjitha detajet.

Është punuar me të gjitha Njësitë Administrative për nëvojat që ato kanë për mallra produkte dhe materiale dhe janë parë edhe mundësitë e realizimit nga ana e Bashkisë duke marrë dhe analizuar të gjitha kërkesat.

Më pas janë hartuar preventiva shpenzimesh për të gjitha llojet e produkteve dhe mallrave dhe janë hartuar pasqyra reale.

Shpenzimet krahasuar me një vit më parë janë dyfishuar, dhe treguesit më kryesorë që mund të analizohen janë:

- Pagat për aparatit janë rritur me 10 % që do të thotë se janë rritur edhe pagat e punonjësve duke afuara nivelin e pagës më të ukët me pagën më të lartë sipas K.M dhe në vlerë absolute 25.5 milion lekë.
- Është rritur niveli i shpenz. Operative për aparatit me rreth 3.8 % ose në vlerë absolute me 963 mijë lekë.
- Janë rritur Investimet për projekte rreth 3 herë nga 4970 mijë lekë në 14500 mijë lekë.
- Është rritur gati me 3.3 herë Fondi i Investimeve për paisje elektrike, Kompjuterike dhe paisje të tjera në krahasim me vitin 2016.
- Janë rritur në mënyrë të ndjeshme shpenzimet Operative për Sportin gati 2 herë. Nga 7.7 milion lekë vitin 2015, në 12.2 milion lekë në vitin 2016 dhe 15.3 milion lekë në vitin 2017.



- Janë rritur shpenzimet Operative për Arsimin nga 20.milion lekë në vitin 2016 në 22 milion lekë në vitin 2017. Gati 2 milion lekë më shumë.

Ne mendojmë se në hartimin e Buxhetit 2018 janë të sintetizuara disa nga detyrat kryesore Bazë të Funksonimit të Pushtetit Vendor që është shërbimi ndaj Komunitetit.Edhe shtimi i numrit të punonjësve

Si përfundim:

Buxheti i Vitit 2018 sipas shumave totale.

Buxheti total i të Ardhurave është si më poshtë:

➤ të ardhura nga granti i vitit 2017.....	34.247.000 lekë
➤ të ardhura të trashëguara nga viti i kaluar.....	8.887.000 lekë
➤ të ardhura nga Granti i Pakushtëzuar.....	134.879.000 lekë
➤ të ardhura nga Granti i Pakushtëzuar Funksione shtesë.....	53.843.000 lekë
➤ të ardhura Planifikuar viti 2016.....	218.765.000 lekë

TOTALI

449.621.000 lekë

Buxheti total për sa i përket Shpenzimeve është si më poshtë:

1 Fondi i pagave për Aparatin.....	74.556.000 lekë
2. Fondi i pagave për Sportin.....	13.980.000 lekë
3. Fondi i pagave për Kulturën.....	1.594.000 lekë
4 Fondi i Sig.Shoq.Shend Aparatin	17.316.000 lekë
5 Fondi i Sig.Shoq.Shend Sportin	2.328.000 lekë
6 Fondi i Sig.Shoq.Shend Kulturën	266.000 lekë
7 Fondi i Qarkut 1%.....	1.800.000 lekë
8 Fondi për nd.Ekon. me Vend.Këshilli.....	2.640.000 lekë
9 Fondi Emergjencave.....	9.300.000 lekë
10 Fondi i Shp.Operative Aparati.....	33.903.000 lekë
11 Fondi i Shp.Operative Kultura.....	1.939.000 lekë
12 Fondi i Shp.Operative Sporti.....	13.932.000 lekë
13 Fondi i Shp.Operative Arsimi.....	32.319.000 lekë
14 Fondi i Shp.Op.Pastrim	41.571.000 lekë
15 Fondi i Shp.Op. Gjelberim.....	13.447.000 lekë
16 Fondi për studime e projekte.....	12.829.000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



17 Fondi për Investime e Paisje.....	97.786.000 lekë
18. Fonde për inv.Nga F.Zhv.Rajoneve.....	997.000lekë
19.Fonde per investime per miremb. Kalesh.....	11.736.000 lekë
TOTALI:.....	384.239.000 lekë

Më poshtë po paraqesim edhe Buxhetet për Funksonet Shtesë.

-Granti për Arsimin ParaUniversitar programi 92302.313.000 lekë

-Shpenzimet:

- Pagat.....1.980.000 lekë
- Sigurimet Shoqerore..... 333.000 lekë

-Granti për Arsimin Parashkollor programi 9120.....28.405.000 lekë

-Shpenzimet:

- Pagat.....24.340.000 lekë
- Sigurimet Shoqerore..... 4.065.000 lekë.
-

-Granti për Administrimin e Pyjeve programi 4260.....1.465.000 lekë

-Shpenzimet:

- Pagat.....999.000 lekë
- Sigurimet Shoqerore.....170.000 lekë
- Shpenzime Operative..... 296.000 lekë

-Granti për Ujitjen dhe Kullimin programi 4240.....12.819.000 lekë

-Shpenzimet:

- Pagat..... 1.272.000 lekë
- Sigurimet Shoqerore..... 214.000 lekë
- Shpenzimet Operative..... 11.333.000 lekë

-Granti për Mbrojtjen nga zjarri dhe Shpëtimi program 10910.....20.380.000 lekë

-Shpenzimet:

- Pagat.....9.307.000 lekë
- Sigurimet Shoqerore.....1.554.000 lekë
- Shpenzimet Operative.....9.519.000 lekë

Gjithsej shuma për shpenzimet nga Funksonet shtesë 65.382 lekë
Dhe në total Fondi i Shpenzimeve 449.621.000 lekë i cili balancohet me të Ardhurat.

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 neni 54 pika “dh”,ku Thuhet se Këshilli “miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
Përcaktojmë edhe nr. e punonjësve si më poshtë:



Numri i punonjësve për vitin 2018

- Bashkia qendër.....99 (nëntëdhjetë e nëntë)
- Punonjës me kontratë100 (Njëqind)
- Punonjës më kontratë sezonale.....20 (njëzet)
- Njësia Vendore Lekaj.....9 (nëntë)
- Njësia Vendore Kryevidh.....9 (nëntë)
- Njësia Vendore Gosë..... 10 (dhjetë)
- Njësia Vendore Sinaballaj.....5 (pesë)
- Punonjes te Gj.Civile.....4 (katër)
- Arsimi Parashkollor.....40 (dyzet)
- Arsimi Parauniversitar.....4 (katër)
- Administrimi I Pyjeve.....2 (dy)
- Ujitja dhe Kullimi.....2 (Dy)
- Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi.....14 (Katërmëdhjetë)
- Qendra Komb. E Biznesit.....1 (një)
- Këshilltarë.....21 (njëzet e një)
- Administratorë.....38 (tridhjetëetë.)
-

Në total 378 (sipas Tabelës së Pagave)

Gjithashtu mbeshtetur në Ligjin nr.9936,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,të ligjit nr.130/2016 “Për Buxhetin e vitit 2017:

Miratohet në Këshillin Bashkiak edhe **KALENDARI ORIENTUES PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE VENDORE 2018.**

**Ose miratimin e Kalendarit të P.B.A (Planit Buxhetor Afatmesëm)
Bashkëngjitur edhe tabelen përkatëse.**



Bashkëngjitur kemi edhe pasqyrat Përkatëse pjesë përbërëse e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2018.

- Pasqyra e përgjithshme e Buxhetit 2018.
- Pasqyra e shpërndarjes mujore të Grantit 2018.
- Pasqyra e shpërndarjes mujore të Grantit të trashëguar 2017
- Pasqyra e shpërndarjes mujore të ardh. të trashëguara 2017
- Pasqyra e shpërndarjes mujore të Ardhura 2018.
- Pasqyra e Limiteve Buxheti 2018.
- Pasqyra e Programimit të Ardhurave 2018.
- Pasqyra e tabelës së pagave dhe nr. Punonjësve 2018
- Pasqyra e investimeve për 2018 + ndarjet në artikuj (01 dhe 05)
- Pasqyrat e parashikimit të shp. Operative sipas sektoreve 2018
- Pasqyra e Kalendarit Orientues për Menaxhimin e Shp. Vendore.

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjithë Drejtoritë dhe zyrat e Bashkisë Rrogozhinë dhe Institucionet në varësi të saj.

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor të Prefektit të Qarkut Tiranë.

**Kryetari Këshillit
Lutfi KASHARI**